



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 988/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., me numër të biznesit 71102130, me seli në Prishtinë, ndërtesa Elektro Kosova, kundër debitorit R,B., me vendbanim në ..., Komuna e Lipjanit, me numër personal ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.B., avokat nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 99/2021, i lejuar me datë 24.03.2021, nga Përmbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka, me seli në Kaçanik, jashtë seancës me datën 15.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas prapësimit të debitorit R,B., të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 99/2021, i lejuar me datë 24.03.2021, nga Përmbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore Prishtinë, Dega Lipjan, Departamentit të Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës KPPP.nr. 988/22 (PPP.nr. 31/21; 2021:095741) në çështjen përmbarimore të kreditorit Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESco) Sh.A., kundër debitorit R,B., vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe gjeti se Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës Komeriale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas prapësimit lidhur me këtë çështje.

Meqenëse në rastin konkret çështja përmbareme zhvillohet në mes të kreditorit si person juridik dhe debitorit si person fizik, lidhur me kërkesën për pagesën e borxhit mbi bazën e ekstraktit nga librat afarist, ndërsa me nenin 13, paragrafi 1, pik 1.1 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: *“kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, ndërsa me pikën 1.2 të të njëjtit nen, përcaktohet se: *“të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbareme, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*, rezulton se kjo çështje nuk bie në kompetencë lëndore të kësaj gjykate për vendosje, pasi që në rastin konkret në cilësinë e kreditorit është personi juridik, ndërsa në cilësinë e debitorit është paraqitur personi fizik.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykata dhe nenin 5, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbareme, kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega Lipjan.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 17 dhe 19 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 988/22, datë 15.03.2023

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate